



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



z. Ekrem ÇITAKU  
Pronar  
Radio VALA RINORE  
Rr/Eqrem Qabej B2/13, 1  
Prishtinë

Ref:1509/1099/LIC/ni

### Vendim

për miratimin e rritjes së fuqisë së transmetimit nga 700W në 1000W të Radio Vala Rinore – me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Vala Rinore, është Shërbyes Medial Audio Vizuel i cili është i licencuar për transmetimin e radio programeve në Regjionin e Prishtinës. Radio Vala Rinore është pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së, me datën 12 mars 2010.
3. Më datën 28 gusht 2015, pronari i Radios Vala Rinore, ka parashtruar një shkresë në zyrën e KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar rritjen e fuqisë së transmetimit nga 700W ERP në 3000W ERP, me qëllim të zgjerimit të zonës së mbulimit.
4. Në bazë të kriterëve të përcaktuara për kategorizimin e Radio dhe TV stacioneve, me rregulloren KPM-2014/03, Radio Vala Rinore bënë pjesë në kategorinë e radio stacioneve me mbulim regjional e cila mbulon më shumë se tri komuna dhe 15-30% të popullsisë së Republikës së Kosovës.
5. Radio Vala Rinore është e licencuar që të transmetoj me fuqi prej 700W ERP, me sistem të antenave 2 x Dipol në koordinatat N 42 39' 40.0''; E 21 10' 27.1'' dhe në lartësi prej

1/2

650 m mbi nivelin e detit. Radio Vala Rinore me këta parametra teknik arrinë të mbulojë 14.9% të territorit të Kosovës respektivisht vendbanimet: Prishtinë, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë si dhe pjesë tjera të territorit të cilat vërehen në hartën e zonës së mbulimit.

### Arsyetimi

6. Komisioni konstatonë se, kërkesa e Radios Valar Rinore për rritjen e fuqisë së transmetimit nga 700W ERP në 3000W ERP nuk është në harmoni me Planin Frekuencor të Kosovës për transmetime radio në brezin frekuencor FM/VHF(87.5 - 108 MHz), respektivisht, frekuenca 94.7 MHz nuk është e planifikuar dhe e koordinuar për përdorim për fuqi transmetimi 3000W ERP, nga lokacioni ku është aktualisht i licencuar për transmetim.
7. Rritja e fuqisë transmetuese, sipas kërkesës së Radio Valës Rinore nga 700W në 3000W ERP, do të rezultojë me rritje të zonës së mbulimit nga 14.9% në 40.21% të territorit të Republikës së Kosovës, që nënkupton njëkohësisht edhe ndryshim të kategorisë së transmetimit, e që është në kundërshtim me rregulloren KPM-2014/03.
8. Në takimin e realizuar me pronarin e Radio Vala Rinore, më 9 tetor 2015, në bazë të analizave të bëra, Zyra Ekzkeutive ka vlerësuar se, mund të lejojë rritjen e fuqisë së transmetimit deri në 1000W për Radio Vala Rinore, në mënyrë që të mundësojë zgjerim të mbulueshmërisë për këtë subjekt dhe në anën tjetër të mos shkaktojë interferenca në punën dhe sinjalin subjekteve tjera transmetuese (radio stacioneve).
9. Propozimi për rritje të fuqisë së transmetimit në 1000W është i pranueshëm edhe për pronarin e Radio Vala Rinore.

### Vendim

10. Komisioni i KPM-së, me datën 20 tetorë 2015, merr vendim për lejimin e rritjes së fuqisë së transmetimit të Radio Valës Rinore nga 700W ERP në 1000W ERP.

### Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
Adnan MEROVCI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

27.10.2015  
datë

Lloji i dërgesës \_\_\_\_\_  
Vista postiljke \_\_\_\_\_

1099.

Vlera e cekur - Shuma e dërguar \_\_\_\_\_  
Oznaçona vlerdosh - postani iznos \_\_\_\_\_

nën numër \_\_\_\_\_  
pod për \_\_\_\_\_  
za \_\_\_\_\_  
PARDHË VALA RINORË / EKREM GJITAKU  
RR/ EKREM QEBEÇI BZ/13,1 / PRISHITINË

(Vendi)  
(Mesto)

Posthtë i nënshkruari deklaroi që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) \_\_\_\_\_  
Dole potpisanu izjavijue da je pomenuta pošiljka (postani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënskrimi i marrësit \_\_\_\_\_  
Potpis primaoca \_\_\_\_\_  
Nënskrimi i nënpunësit të postës së vendit \_\_\_\_\_  
Potpis radnika pošte \_\_\_\_\_



30.10.2015